

LIGJ
Nr. 58/2024

PËR RATIFIKIMIN E TRAKTATIT TË MIQËSISË DHE BASHKËPUNIMIT
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE UKRAINËS

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI

Neni 1

Ratifikohet Traktati i Miqësisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Ukrainës sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 6.6.2024.

Shpallur me dekretin nr. 233, datë 25.6.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

TRAKTATI I MIQËSISË DHE BASHKËPUNIMIT
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE UKRAINËS

Republika e Shqipërisë dhe Ukraina, në vijim të referuara si “Palët”,
të udhëhequra nga Komunikata e Përbashkët për Vendosjen e Marrëdhënieve Diplomatike ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Ukrainës, e datës 13 janar 1993;

me dëshirën për të vendosur themelet politike të partneritetit të tyre afatgjatë, konstruktiv dhe dinamik, dypalësh dhe shumëpalësh;

duke konfirmuar respektimin dhe përkushtimin e tyre ndaj parimeve dhe normave demokratike në marrëdhëniet ndërmjet shteteve sovraane, të cilat duhet të zhvillohen në bazë të partneritetit, besimit të ndërsjellë, inspektimit të vlerave dhe idealeve të përbashkëta të lirisë, demokracisë, drejtësisë, solidaritetit dhe dinjitetit njerëzor;

duke konfirmuar respektimin e shtetit të së drejtës, të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;

duke vënë në dukje rëndësinë e forcimit të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare nëpërmjet parandalimit të konflikteve, menaxhimit të krizave, çarmatimit dhe parandalimit të përhapjes së armëve bërthamore dhe armëve të tjera të shkatërrimit në masë;

të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë e tyre të përbashkët, si shtete anëtare të Kombeve të Bashkuara, për ndërtimin, së bashku me kombet e tjera, të një rendi të ri politik dhe ekonomik botëror, të bazuar në drejtësinë sociale dhe të drejtat e njeriut, respektimin e pavarësisë kombëtare, integritetin territorial dhe mjedisin; dhe

me dëshirën për të forcuar lidhjet historikisht të forta midis popujve të tyre dhe për të nxitur bashkëpunimin dypalësh në të gjitha fushat dhe hapësirat e mundshme në dobi të tyre të ndërsjellë,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Palët bien dakord të zhvillojnë marrëdhëniet e tyre si shtete mike në përputhje me kartën e OKB-së, instrumentet përkatëse të të drejtave të njeriut dhe parimet dhe angazhimet e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Marrëdhëniet e tyre do të karakterizohen nga besimi i ndërsjellë, respekti, solidariteti, bashkëpunimi dhe angazhimi i përbashkët për demokracinë dhe lirinë ekonomike.

2. Palët do të mbështesin integritetin territorial dhe pavarësinë politike të njëra-tjetrës, do të promovojnë bashkërisht në arenën ndërkombëtare respektimin e këtyre parimeve, si dhe parimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërkombëtare ndërmjet shteteve me mjete politike dhe diplomatike, sipas normave dhe parimeve të së drejtës ndërkombëtare, duke përdorur mekanizmat e Kombeve të Bashkuara, Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, si dhe dokumente ndërkombëtare në të cilat janë palë.

Neni 2

1. Palët do të përmbushin detyrimet e tyre, me mirëbesim, sipas së drejtës ndërkombëtare dhe do të promovojnë fqinjësinë e mirë në marrëdhëniet e tyre.

2. Palët do të bashkëpunojnë brenda organizatave ndërkombëtare përkatëse për të promovuar të drejtat e njeriut, vlerat demokratike, drejtësinë sociale dhe mirëqenien.

Neni 3

1. Palët bien dakord të mbajnë një dialog të rregullt në nivelin më të lartë politik të dy shteteve për çështjet kryesore të marrëdhënieve të tyre dypalëshe, për zhvillimet në shtetet e tyre, si dhe për çështjet me interes të përbashkët.

2. Palët do të nxisin bashkëpunimin në të gjitha nivelet, duke përfshirë konsultimet ndërmjet ministrive të jashtme, organeve legjislativë dhe ekzekutive, zyrtarëve publikë dhe organizatave private, me synimin për të siguruar zgjerimin dhe thellimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të tyre dypalëshe dhe për të koordinuar qëndrimet e tyre për çështjet ndërkombëtare.

3. Palët do të negociojnë në mënyrë konstruktive për çështjet dypalëshe, duke respektuar aspiratat dhe interesat e njëra-tjetrës.

4. Komisionet e përziera dhe organet e tjera të përhershme ose *ad hoc* do të krijohen sipas kërkesës dhe me marrëveshje të ndërsjellë.

Neni 4

Palët do të zgjerojnë dhe do të rrisin bashkëpunimin brenda Kombeve të Bashkuara, me synimin për të forcuar rolin e Organizatës për Ruajtjen e Paqes dhe Sigurisë Ndërkombëtare, për të promovuar zhvillimin, mirëqenien dhe të drejtat e njeriut kudo, për të konsoliduar operacionet paqeruajtëse të Organizatës, duke përfshirë parandalimin e konflikteve dhe të krizave, për të rritur efektivitetin e sistemit të sigurisë kolektive të parashikuar në Kartën e OKB-së, për të ndërtuar kontributin e Kombeve të Bashkuara në zgjidhjen e problemeve bashkëkohore globale nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta dhe përmes konsolidimit të rendit ndërkombëtar të bazuar në rregulla.

Neni 5

Palët do të bëjnë më të mirën e mundshme për të nxitur mirëkuptimin dhe bashkëpunimin reciprok në Evropë. Ata do të punojnë së bashku në rritjen e efektivitetit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, veçanërisht si një instrument për parandalimin dhe zgjidhjen paqësore të konflikteve, dialogun, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pakicave kombëtare dhe zhvillimin e institucioneve demokratike.

Neni 6

1. Palët do të nxisin dhe lehtësojnë kushte të favorshme për aktivitetin tregtar dypalësh, duke përfshirë tregtinë dhe investimet në sipërmarrje të përbashkëta. Ato do të inkurajojnë aktivitetet sipërmarrëse midis dy vendeve.

2. Palët do të përpiqen të krijojnë kushte të favorshme për bashkëpunimin ekonomik, praktikat e drejta dhe të barabarta të biznesit, transparencën e tregut dhe shkëmbimin më të madh të informacionit të biznesit. Ata do të përpiqen ta pasqyrojnë këtë nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, institucione të tjera financiare ndërkombëtare.

3. Nëse nuk është rënë dakord ndryshe, Palët do t'i japin përparësi kulturës dhe trashëgimisë kulturore, tregtisë, investimeve dhe bashkëpunimeve të tjera ekonomike, në fusha të tilla si: energjia, bujqësia, telekomunikacioni, minierat, transporti, ndërtimi, përpunimi i ushqimit, industria farmaceutike, mjedisi, shërbimet profesionale dhe fusha të tjera me interes të përbashkët.

Neni 7

Palët i kushtojnë rëndësi të veçantë forcimit të sistemit tregtar shumëpalësh. Ato do të mbështesin hapat e mëtejshëm drejt liberalizimit, transparencës dhe zbatimit të parimeve të Organizatës Botërore të Tregtisë dhe Forumeve të tjera shumëpalëshe, në lidhje me tregtinë dhe investimet.

Neni 8

1. Palët njohin rëndësinë globale të mbrojtjes së mjedisit. Ata do të rrisin bashkëpunimin e tyre në mbrojtjen e mjedisit dhe në ruajtjen në nivel kombëtar dhe rajonal të ekosistemeve të brishta të botës, duke reflektuar dëshirën e përbashkët të popujve të tyre.

2. Palët do të punojnë së bashku në kërkimin e zgjidhjes së problemeve mjedisore dhe në zbatimin e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm për përdorimin e burimeve natyrore.

Neni 9

Palët do të bashkëpunojnë për të parandaluar dhe për të luftuar krimin e organizuar, trafikun e paligjshëm të drogës, terrorizmin, aktet e paligjshme kundër sigurisë së aviacionit civil dhe lundrimit detar dhe kontrabandën, duke përfshirë bashkëpunimin për ndalimin dhe për parandalimin e importit, eksportit dhe transferimit të paligjshëm të pronësisë së pasurisë kulturore.

Neni 10

Palët do të zhvillojnë kontakte dhe shkëmbime ushtarake. Ata do të shkëmbejnë rregullisht mendime dhe informacione për doktrinat e tyre ushtarake dhe çështje të tjera, dhe çështje të tjera me interes të përbashkët ushtarak.

Neni 11

1. Duke njohur rëndësinë e shkëmbimeve në fushat e kulturës dhe trashëgimisë kulturore për mirëkuptimin e ndërsjellë midis popujve, Palët do të zhvillojnë më tej bashkëpunimin e tyre dypalësh në fushat e kulturës dhe të trashëgimisë kulturore.

2. Palët do të nxisin bashkëpunimin e drejtpërdrejtë ndërmjet institucioneve arsimore, arkivore, kulturore dhe të trashëgimisë kulturore dhe krijuese, dhe organizatave kulturore, dhe të trashëgimisë kulturore të të dyja shteteve, si dhe ndërmjet shoqatave dhe shoqërive në këto fusha.

3. Palët do të organizojnë marrëveshje dhe bashkëpunime në kuadër të nxitjes së iniciativave të përbashkëta të institucioneve përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në territoret e të dyja vendeve, që kanë për qëllim njohjen, promovimin, respektimin reciprok të vlerave të trashëgimisë kulturore dhe të së kaluarës historike, shpërndarjen e informacionit dhe zhvillimin e shkëmbimit kulturor.

4. Palët do të angazhohen për të mbështetur shtetin palë në strehimin e artefakteve kulturore të rrezikuara në rastet e konflikteve të armatosura.

Neni 12

1. Palët do të bëjnë përpjekjet maksimale për të krijuar kushte për zgjerimin e kontakteve të drejtpërdrejta ndërmjet individëve, institucioneve dhe organizatave.

2. Palët do të nxisin zgjerimin e kontakteve ndërmjet partive politike, sindikatave, fondacioneve, institucioneve të arsimit, të drejtave të njeriut, organizatave fetare, të grave dhe rinisë, shoqatave mjedisore dhe të tjera.

3. Palët do të zhvillojnë kontakte dhe shkëmbime ndërparlamentare, duke përfshirë ato ndërmjet përfaqësuesve të partive të ndryshme dhe lëvizjeve popullore të të dyja shteteve. Palët do të nxisin shkëmbimin e përvojës në formulimin dhe miratimin e legjislacionit.

Neni 13

Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Ukrainës në nivel rajonal dhe bashkiak dhe do të bashkëpunojnë në sferën e mbrojtjes sociale të popujve të Republikës së Shqipërisë dhe Ukrainës.

Neni 14

Palët do të sigurojnë, në bazë të reciprocitetit, kushte për funksionimin normal të misioneve diplomatike, konsullore dhe të misioneve të tjera zyrtare të njëra-tjetrës.

Neni 15

Palët do të hyjnë në marrëveshje dhe rregullime shtesë, nëse është e nevojshme, me qëllim zbatimin e dispozitave të këtij Traktati. Ata do të vazhdojnë zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese dypalëshe dhe do t'i shqyrtojnë ato, nëse është e nevojshme.

Neni 16

1. Dispozitat e këtij Traktati nuk paragjykojnë angazhimet e Palëve, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe dhe shumëpalëshe të lidhura më parë.

2. Ky Traktat nuk drejtohet kundër shteteve të treta.

Neni 17

1. Ky Traktat do t'i nënshtrohet ratifikimit në përputhje me procedurat kushtetuese të secilës Palë dhe do të hyjë në fuqi në ditën e shkëmbimit të instrumenteve të ratifikimit.

2. Ndryshimet e këtij Traktati do të bëhen me shkrim dhe do të hyjnë në fuqi, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

3. Ky Traktat do të qëndrojë në fuqi për një periudhë dhjetëvjeçare dhe do të zgjatet automatikisht për periudhat pasuese pesëvjeçare nëse asnjëra nga Palët nuk deklaron dëshirën e saj për ta përfunduar atë nëpërmjet denoncimit, jo më pak se një vit përpara ditës së synuar të përfundimit.

Në dëshmi sa më sipër, të poshtëshënuarit kanë nënshkruar këtë Traktat.

Bërë në Tiranë, në datën 28 shkurt 2024, në dy kopje, në gjuhët shqipe, ukrainase dhe angleze, ku secili version është njëloj autentik. Në rast mospërputhjeje në interpretim, versioni në gjuhën angleze ka përparësi.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

PËR UKRAINËN

TREATY
ON FRIENDSHIP AND COOPERATION
BETWEEN
THE REPUBLIC OF ALBANIA
AND
UKRAINE

THE REPUBLIC OF ALBANIA AND UKRAINE, hereinafter referred to as the "Parties",

GUIDED by the Joint Communiqué on the Establishment of Diplomatic Relations between the Republic of Albania and Ukraine of January 13, 1993;

DESIRING to set the political foundations of their long-term, constructive and dynamic partnership, bilaterally and multilaterally,

CONFIRMING their respect for and commitment to democratic principles and norms in relations between sovereign states, which should be developed on the basis of partnership, mutual trust, adherence to the common values and ideals of freedom, democracy, justice, solidarity and human dignity,

CONFIRMING their observance of the rule of law, human rights and fundamental freedoms,

NOTING the importance of strengthening international peace and security through conflict prevention, crisis management, disarmament and the prevention of the proliferation of nuclear weapons and other weapons of mass destruction,

CONSCIOUS of their common responsibility, as United Nations member states, for the building, along with other nations, of a new world political and economic order, based on social justice and human rights, respect for national independence, territorial integrity and the environment, and

DESIRING to strengthen the historically strong links between their peoples and to promote bilateral cooperation in all possible fields and areas to their mutual benefit,

HAVE AGREED AS FOLLOWS:

Article 1

1. The Parties agree to develop their relations as friendly states in accordance with the UN Charter, relevant human rights instruments, and the principles and commitments of the Organization for Security and Cooperation in Europe. Their relations shall be characterized by mutual trust, respect, solidarity, cooperation and a common commitment to democracy and economic freedom.
2. The Parties shall support the territorial integrity and political independence of each other, jointly promote on the international arena the observance of these principles as well as the principle of the resolution of international disputes between states by political and diplomatic means according to the norms and principles of international law, using the mechanisms of the United Nations, the Organization for Security and Cooperation in Europe, as well as international documents to which they are parties.

Article 2

1. The Parties shall fulfil in good faith their obligations under international law and promote good neighborliness in their relations.
2. The Parties shall cooperate within the relevant international organizations to promote human rights, democratic values, social justice and prosperity.

Article 3

1. The Parties agree to maintain a regular dialogue at the highest political level of the two states on principal issues of their bilateral relations, on developments in their states, as well as on issues of mutual concern.
2. The Parties shall promote cooperation at all levels, including consultations between Foreign Ministries, legislative and executive bodies, public officials and private organizations with the aim of ensuring further expansion and deepening of their bilateral relations and of coordinating their stands on international issues.
3. The Parties shall negotiate constructively on bilateral issues respecting each other's aspirations and interests.
4. Mixed commissions and other standing or *ad hoc* bodies shall be established as required and by mutual agreement.

Article 4

The Parties shall expand and enhance cooperation within the United Nations with a view to strengthen the role of the Organization for the maintenance of international peace and security, to promote development, welfare and human rights everywhere, to consolidate the Organization's peacekeeping operations, including the prevention of conflicts and crises, to increase the effectiveness of the collective security system provided for in the UN Charter, to build up the United Nations contribution to the solution of contemporary global problems by joint efforts and through the consolidation of the rules-based international order.

Article 5

The Parties shall do their utmost to foster mutual understanding and cooperation in Europe. They shall work together in enhancing the effectiveness of the Organization for Security and Cooperation in Europe, particularly as an instrument for the prevention and peaceful resolution of conflicts, dialogue, the protection of human rights and the rights of national minorities and the development of democratic institutions.

Article 6

1. The Parties shall promote and facilitate favorable conditions for bilateral commercial activity, including trade and joint venture investment. They shall encourage entrepreneurial activities between the two countries.
2. The Parties shall endeavor to create favourable conditions for economic cooperation, fair and equitable business practices, market transparency, and greater exchanges of business information. They shall endeavor to reflect this through their participation in the International Monetary Fund, the International Bank for Reconstruction and Development, the European Bank for Reconstruction and Development, other international financial institutions.
3. Unless otherwise agreed, the Parties shall accord priority to culture and cultural heritage, trade, investment, and other economic cooperation in areas such as energy, agriculture, telecommunications, mining, transportation, construction, food processing, pharmaceutical, environment, professional services, and other areas of mutual interest.

Article 7

The Parties attach particular importance to strengthening the multilateral trading system. They shall support further steps toward liberalization, transparency, and the implementation of the principles of the World Trade

Organization and other multilateral fora concerning both trade and investment.

Article 8

1. The Parties recognize the global importance of environmental protection. They shall enhance their cooperation in the protection of the environment and preservation at the national and regional level of the world's fragile ecosystems, reflecting the common desire of their peoples.
2. The Parties shall work together in seeking to resolve environmental problems, and in applying the principle of sustainable development to the use of natural resources.

Article 9

The Parties shall cooperate to prevent and combat organized crime, illegal drug trafficking, terrorism, illegal acts against the security of civil aviation and sea navigation, and smuggling, including the cooperation to prohibit and prevent the illicit import, export and transfer of ownership of cultural property.

Article 10

The Parties shall develop military contacts and exchanges. They shall regularly exchange opinions and information on their military doctrines and other issues of common military interest.

Article 11

1. Recognizing the importance of exchanges in the fields of culture and cultural heritage for mutual understanding between peoples, the Parties shall develop further their bilateral cooperation in the fields of culture and cultural heritage.
2. The Parties shall promote direct cooperation between educational, archival, cultural and cultural heritage, and creative institutions as well as cultural and cultural heritage organizations of the two countries states, as well as between associations and societies in these fields.
3. The Parties shall cooperate and conclude agreements within the framework of promoting joint initiatives of the institutions responsible for cultural heritage in the territories of both countries, which aim to recognize, promote, and mutually respect the values of cultural heritage

and the historical past, the dissemination of information and the development of cultural exchange.

4. The Parties shall commit to support one another in housing endangered cultural artifacts in cases of armed conflicts.

Article 12

1. The Parties shall make best efforts to create conditions for the expansion of direct contacts between individuals, institutions and organizations.
2. The Parties shall promote the expansion of contacts between political parties, trade unions, foundations, institutions of education, human rights, religious, women's and youth organizations, environmental and other associations.
3. The Parties shall develop interparliamentary contacts and exchanges, including those between representatives of different parties and popular movements of the two states. The Parties shall promote the sharing of experience in the formulation and enactment of legislation.

Article 13

The Parties shall encourage cooperation between the Republic of Albania and Ukraine at the regional and municipal levels and shall cooperate in the sphere of social protection of people of the Republic of Albania and Ukraine.

Article 14

The Parties shall ensure, on the basis of reciprocity, conditions for the normal functioning of each other's diplomatic, consular and other official missions.

Article 15

The Parties shall enter into additional agreements and arrangements, if necessary, with a view to implementing the provisions of this Treaty. They shall continue implementation of existing bilateral agreements and review them, if necessary.

Article 16

1. The provisions of this Treaty are without prejudice to the commitments of the Parties under previously concluded bilateral and multilateral international agreements.
 2. This Treaty is not directed against third states.
-


Article 17

1. This Treaty shall be subject to ratification in accordance with the constitutional procedures of each Party and shall enter into force on the day of exchange of the instruments of ratification.
2. Amendments to this Treaty shall be made in writing and shall enter into force in accordance with paragraph 1 of this article.
3. This Treaty shall remain in force for a period of ten years and shall be automatically extended for subsequent five-year periods if neither Party declares its desire to terminate it by denunciation, no less than one year before the intended day of termination.


IN WITNESS WHEREOF, the undersigned have signed this Treaty.

DONE at Tirana, this 28 day of February 2024, in two copies, in the Albanian, Ukrainian and English, languages, each version being equally authentic. In case of divergence in interpretation, the English version shall prevail.

FOR THE REPUBLIC OF ALBANIA

A blue ink signature, appearing to be 'Edi Rama', written over a horizontal line.

FOR UKRAINE

A blue ink signature, consisting of a large loop followed by a horizontal stroke and another large loop, written over a horizontal line.